



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 51 Prot.,

Tiranë, 01.032024

VENDIM

Nr. 43, datë 01.03.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 01.03.2024:

VENDOSI:

1. Miratimin e Koncept Sondazhit Arkeologjik për projektin “Rikonstruksion objekt ekzistues 1 kat me shtesë anësore dhe shtesë 1 kat”, Rruga ‘Kasëm Durrësi’, Bashkia Durrës, Brenda Kufirit Zonë Arkeologjike “B” Durrës, me aplikues z. Taulant Rama dhe zhvillues z. **Ilir Shehdula**;
2. Zhvilluesi duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të projektit “Rikonstruksion i objektit ekzistues 1 kat me shtesë anësore dhe shtesë 1 kat”, Rruga ‘Kasëm Durrësi’, Bashkia Durrës, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin e projektit sipas Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;
3. Thellësia e Koncept Sondazhit të jëtë në varësi të shtresës natyrore gjeologjike (sterile).
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
5. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
6. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI



KRYETAR
Blendi GONXHJA